



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

B.Curri, më 20 . 06. 2025

Nr. 2759 prot.

P/ VENDIM

Nr _____ Datë _____ . 06. 2025

**PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VKB NR. 65 TE DATES 09. 07. 2024, PËR
VENDOSJEN E KUFIZUESVE TE SHPEJTESISË NE RRUGET E BASHKISË.**

Mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit 44/ 2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjit Nr. 8378, datë 22. 07. 1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, dhe me kërkesën e një grupe banorëve të Lagjes “Partizani”, (Gjyriq), dhe të banorëve nga lagjet e tjera të qytetit dhe të fshatit Margegaj, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Tropojë në mbledhjen e datës _____ . 06. 2025:

VENDOSI

1) Miratimin e vendosjes së kufizuesve të shpejtësisë, sipas standarteve të percaktuara teknike dhe bashkëkohore, në të gjitha rrugët e Bashkisë Tropojë, aty ku ashtë e domosdoshme, sipas hartës bashkelidhur, duke filluar nga rruga “Sylejman Vokshi”, (Markate- Spital), rruga “Ram Sadria”, nga Kryqezimi tek Lloçi dhe në Fshatin Margegaj, Rruga “Harry Bajraktari”, deri në Koj, Rruga “Agim Ramadani”, dhe kështu me radhë, sipas hartës bashkëngjitur këtij vendimi.

2) Me zbatimin e këtij vendimi si dhe me përcaktimin e plotësimit të kërkesave të tjera, të mundshme, ngarkohen, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike, dhe Policia Bashkiake.

Propozuesi: DPZHT

M. Vatoci

E. Musaj

E. Muhametaj

H. Isufaj

KRYETARI I BASHKISË

REXHË BYBERI

Juristi: _____

Ne mungese dhe me urdher
N/ Kryetarija e Bashkisë
Zyra Islamaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 2754 Prot.
11

B.Curri, më 02. 06. 2025

Lënda: RELACION.

Per: Vendosjen e kufizuesve te shpejtesise ne rruget e Bashkise.

Të nderuar Këshilltarë!

Nisur nga numri në rritje i kërkesave të qytetarëve, si dhe nga kërkesa juaj e dates protokolluar prane Bashkise Tropoje me nr.2458 Prot. date 02.06.2025 për të propozuar vend-vendosjen e kufizuesve të shpejtësisë në disa segmente rrugore të Bashkisë që paraqesin rrezikshmëri të lartë, ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim këtë projekt-vendim.

Propozimi ynë parashikon vendosjen e kufizuesve të shpejtësisë në rrugët më të frekuentuara dhe problematike të territorit, në përputhje me standardet bashkëkohore të sigurisë rrugore. Kufizuesit e parashikuar janë të llojit me asfalt (ku futet dhe sinjalizimi i rruges) ose te llojit gome, të montueshëm dhe me cilësi të lartë, të cilët nuk përbëjnë rrezik për përdoruesit e rrugës, përkundrazi do të shërbejnë si masa parandaluese ndaj aksidenteve rrugore.

Për të përcaktuar saktësisht nevojat dhe vendndodhjen e këtyre strukturave, është planifikuar të zhvillohen diskutime me Policinë Rrugore, Drejtorinë e Urbanistikës dhe Këshillin Bashkiak ne mbledhjen e rradhes, ku do të vendoset për mënyrën e zbatimit, përfshirë rastet kur mund të përdoren ngadalësues asfaltikë ose ngadalësues gome në varësi të tipologjisë së rrugës.

Gjithashtu, në rastet kur ekzistojnë kufizues të vendosur jashtë kriterëve teknike, propozojmë heqjen e tyre dhe zëvendësimin me kufizues të rinj, të ndërtuar me përmasa optimale dhe në përputhje me infrastrukturën përkatëse.

Vlen të theksohet se siguria rrugore nuk arrihet vetëm përmes ndërhyrjeve fizike, por mbi të gjitha përmes ndërgjegjësimit të drejtuesve të mjeteve dhe respektimit të rregullave të qarkullimit. Aty ku janë të vendosura vijat e bardha, nëse rregullat respektohen, ato janë në vetvete forma më efikase e ngadalësimit të shpejtësisë dhe sigurisë së këmbësorëve.

Bashkëlidhur këtij relacioni është harta orientuese që përcakton segmentet rrugore ku parashikohet ndërhyrja, përkatësisht:

- Rruga “Binak Alia” (segmenti Markat–Spital),
- Rruga “Agim Ramadani” (segmenti Sheh–Gjimnaz),
- Rruga “Harry Bajraktari” (duke përfshirë lagjen “Koj”),
- Rruga “Ram Sadria” (duke përfshirë zonën Margegaj).

Në hartë janë shënuar kufizuesit ekzistues, ata të rinj që do të vendosen dhe kufizuesit që do të hiqen për shkak të vendosjes jashtë standardeve. Kjo hartë do të shfaqet në mënyrë vizuale edhe gjatë mbledhjes së Këshillit për një diskutim më të qartë dhe të strukturuar.

Bashngjitur këtij relacioni teknik gjindet dhe nje informacion me detajues ne lidhje me vendosjen e kufizuesve te shpejtesise ne rruget e Bashkise Tropoje.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, mbështetjen dhe bashkëpunimin, kërkojmë miratimin e këtij projekt-vendimi në funksion të përmirësimit të sigurisë rrugore në territorin e Bashkisë Tropojë.

Faleminderit !'

Drejtoria e PZHT-se.

M. Vatodi.

E. Musaj

E. Muhametaj

H. Isufaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 2754 / Prot. 2

B. Curri, më 20 . 06 . 2025

Lënda: INFORMACION.

Per: Vendosjen e kufizuesve te shpejtesise ne rruget e Bashkise,

TE NDERUAR KESHILLTARE !"

Nisur nga fakti se qe kemi shume kerkesa nga banoret si dhe nga ana juaj per te vendosur kufizuesit e shpejtesise ne rruget qe ka me shum fluks dhe emergjence per vendosjen e tyre, po iu japin nje informacion me te hollesishem per kufizuesit e shpejtesise (bumat) ku kushtet kryesore teknike te vendosjes se tyre jane :

Përmasat dhe Dizajni i Bumave

- **Lartësia dhe Gjerësia e Bumave:** Bumet e shpejtësisë duhet të kenë lartësi dhe gjerësi të përshtatshme për të siguruar efektivitetin e ngadalësimit të shpejtësisë, por pa shkaktuar dëme për automjetet ose për sigurinë e pasagjerëve. Lartësia tipike e një bume është mes **6 dhe 10 cm**, ndërsa gjerësia mund të variojë nga 50 deri në 150 cm, në varësi të kushteve të rrugës dhe materialit që perdoret
- **Forma e Bumës:** Bumat mund të jenë të ndryshme në formë, por ato më të zakonshmet janë **bumat e sheshtë**, që janë të dizajnuara për të ngadalësuar automjetet gradualisht. Disa mund të jenë në formën e "U"-së ose të rrafshuar për të minimizuar ndikimin e tyre tek makinat dhe për të shmangur dëmtimin e pjesëve të poshtme të automjetit.
- **Materialet e Ndërtimit:** Bumat e shpejtësisë janë zakonisht të ndërtuara nga **gomë**, **asphalt** ose **plastik**. Materialet duhet të jenë të mjaftueshme për të siguruar që buma të jenë të qëndrueshme dhe të ofrojnë një sipërfaqe të mirë për kalimin e automjeteve.

Vendndodhja dhe Distribuiimi i Bumave

- **Zonat e Përshtatshme për Vendosjen e Bumave:** Bumat vendosen kryesisht në rrugë që kalojnë përmes **zonave të banuara**, pranë **shkollave**, **spitaleve**, dhe në rrugë ku ka kalim të këmbësorëve. Ata janë gjithashtu të përdorur në rrugë me **kthesa të mprehta**, **rampë ngjitjeje** ose **rruga me vizibilitet të ulët**.
- **Distanca midis Bumave:** Bumet duhet të vendosen me një distancë të përshtatshme nga njëra-tjetra për të parandaluar shpejtësinë e automjeteve të kthehen përsëri në nivele të rrezikshme pas kalimit të bumës. Distanca ideale midis bumave varion nga 100 deri në 200 metra, në varësi të kushteve të rrugës dhe nevojës për ngadalësimin e shpejtësisë.

Shenja të Qarta dhe Paralajmërimet

- **Sinjalistika Rrugore për Bumet:** Para se shoferët të arrijnë te buma, duhet të vendosen shenja të qarta të paralajmërimit për të treguar që ndodhet një bume e shpejtësisë. Këto mund të jenë **shenja të ndritshme, tabela informuese ose shenja paralajmëruese të ngadalësimit të shpejtësisë**, që njoftojnë shpejtësinë e rekomanduar (p.sh., 30 km/h ose 20 km/h).
- **Përshkrimi i Bumave:** Rekomandohet që bumet të jenë të ngjyrosura me **ngjyra të dallueshme** (p.sh., ngjyrë e kuqe ose ngjyrë e verdhë) dhe të kenë **shkronja ose simbole reflektuese** për t'u siguruar që janë të dukshme gjatë natës ose në kushte të pamjaftueshme dritës.

Siguria e Shoferëve dhe Efienca e Bumave


- **Zbutja e Ndikimit të Bumës:** Bumat duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të përballojnë ndikimin e makinave, duke shmangur dëmtimet për shoferët dhe pasagjerët. Shumica e bumave janë të projektuar për të ofruar një ngadalësim të butë, duke shmangur tronditjet e papritur të forta që mund të dëmtojnë automjetin ose të rrezikojnë sigurinë e pasagjerëve.

Vlerësimi dhe Përshatja e Bumave

- **Monitorimi dhe Përshatja e Efektivitetit:** Pas vendosjes së bumave, është e rëndësishme të monitorohet efikasiteti i tyre dhe të bëhen rregullime të nevojshme për të siguruar që ato nuk shkaktojnë ngërçe në trafik, por në të njëjtën kohë sigurojnë uljen e shpejtësisë dhe rritjen e sigurisë.

Prandaj për realizimin e bumave në rrugë mund të bëhet

- Me asfalt (ku futet dhe sinjalizimi I rruges) ku vlera e realizimi të saj shkon **152,041 leke** për vendosjen e bumit për dy korsë ose **116,172 leke** për vendosjen e bumit për rrugë me një korsë por për shkak të sasisë shumë të vogël që paraqet asfalti , industrite e asfaltit nuk marrin persiper prodhimin e tyre për shkak të Kostos së madhe ekonomike , prandaj realizimi i tyre mund të bëhet vetëm kur kemi asflatin e një rrugë tjetër dhe bashkë me të realizohen dhe bumet . Psh në vijim do sistemohet dhe asfaltohet rruga Gjinnaz-Spitali , prandaj mund të provojmë realizimin e bumave në lagjen Gjyriqi sipas VKB së miratuar





- Me kufizues shpejtesie te gatshme te cilat mund te blihen ne baze te cmimit te tregut ku per realizimin e saj nevojiten **57,047 leke** per rrugen me dy korsi dhe **28,946 leke** per vendosjen e nje bume gome me nje korsi ,por per arsye se ne baze te ligjit ne fuqi VKM 216 date 13.04.2023 llogaritja e vleres e punimeve duhet fillimisht te behet ne baze te manualit ne fuqi , dhe vetem ne kushte qe nuk mund te perdoren vlerat e manualit mund te kalohen tek perdorimi i analizes se cmimit te tregut.

Sqarojme se ne cdo rast kemi dhene informacion ne lidhje me problematikat e drejtuar ndaj neshe , sic eshte dhe rasti I vendsosjes se bumave ne rruge ku kemi derguar ne mbledhjen e Majit 2024 relacion dhe projekt-vendim per miratim , ku ne korrik 2024 keni dalur me miratimin e Vendimit nr.65 date 09.07.2024.

Prandaj ne konkluzion , nese shoferet nuk respektojne kufizuesit e shpejtesise qe eshte 20 km/h ne zonat urbane , nuk ndalen neper ishujt ne rruge , dhe nuk sensibilizohen nga gjrobat qe marrin nga shkelja e tyre duke rrezikuar jeten e kembesoreve , atehere te shifet e arsyeshme qe bumet te behen ne baze te kerkeses se qytetareve dhe vendet te miratohen nga Keshilli Bashkiak ne diskutime me Policine rrugore dhe Bashkine Tropoje duket perdorur studimin e tregut , ne baze te kushteve ekonomike te sigurimit te fondit dhe miratimit te vendimeve te sipercituara dhe pastaj te vijohen me realizimin e bumeve sipas metodologjikes perkatese.

Duke iu falenderuar per mirekuptimin!

Drejtoria e PZHT-se.

M. Vatoci

E. Musaj

E. Muhametaj

H. Isufaj



